



**REPUBLIKA E SERBIË
MINISTRIA E ARSIMIT**



SHOQATA E KIMISTËVE TË SERBIË

**GARA KOMUNALE NGA KIMIA
(15 mars 2026)**

TESTI PËR KLASËN E 7

Shifra e nxënësit

--	--	--	--	--	--

(tri shkronja dhe tre numra)

Testi ka 20 detyra. Lexo me kujdes tekstin e secilës detyrë, ndërsa përgjigjet shkruaji në mënyrën siç kërkohet në detyrë (duke rrethuar shkronjën para përgjigjes, duke shkruar përgjigjen në vijën e paraparë, etj.), pasi vetëm përgjigjet e shkruara kështu do të vlerësohen nga Komisioni. Hapësirën e zbrazët nën tekstin e detyrës mund ta përdorësh për të shkruar procedurën e zgjidhjes. Testi plotësohet me kimik me ngjyrë të kaltër ose të zezë, ndërsa përgjigjet e shkruara me laps grafit nuk do të shqyrtohen. Për zgjidhjen e testit mund të përdorësh vetëm mjetet e shkrimit dhe kalkulatorin (digitronin), ndërsa përdorimi i celularit, orëve inteligjente dhe pajisjeve të tjera elektronike është i ndaluar. Nuk lejohet as përdorimi i materialeve shtesë të shtypura, duke përfshirë edhe Sistemin Periodik të elementeve.

Koha e punimit të testit është 120 minuta.

Ju urojmë sukses në punë!

E plotëson komisioni:

Numri i përgjithshëm i pikëve të arritura: _____ (nga 100 të mundshme)

Nënshkrimi i kryetarit të Komisionit komunal

1. Në vija shkruaj **NF**, nëse është përshkruar ndryshimi fizik, apo **NK** nëse është përshkruar ndryshimi kimik.
- a) Dordoleci i borës në kopshtin e shkollës sot është shkrirë plotësisht. _____
 - b) Në torten e ditëlindjes digjeshin qirinjtë me ngjyra të ndryshme. _____
 - c) Për kafjallt kemi fërguar ve. _____
 - d) Kemi copëtuar kubat e akullit për përgatitjen e pijeve freskuese. _____
2. Arsimtari Krenar pajisë laboratorin e shkollës. Në fotografi është treguar rafti me enët dhe mjetet laboratorike. Për t'ua lehtësuar orientimin nxënësve në laborator, arsimtari ka planifikuar që nën secilin mjet të ngjitet një kartelë me emrin përkatës. Në fushat e zbrazëta në fotografi shkruani numrat që u përgjigjen emrave të objekteve.




1. Hinka
2. Qelq ore
3. Menzura
4. Gota
5. Erlenmajeri
6. Balona
7. Shkopi i qelqit

3. Në fushat e zbrazëta shkruaj $>$ (më i madhë), $<$ (më i vogël) apo $=$ (i barabartë).

Numri i elektroneve në katjonin e elementit X		Numri i elektroneve në atomin e elementit X
Numri i elektroneve në anionin e elementit Y		Numri i elektroneve në atomin e elementit Y
Numri i protoneve në atomin e elementit Z		Numri i elektroneve në atomin e elementit Z
Numri i nukleoneve në atomet e elementeve të ndryshëm nga hidrogjeni		Numri i elektroneve në atomet e këtyre elementeve

4. Një kimist, në bazë të një sërë eksperimentesh, zbuloi një substancë të re. Në bazë të rezultateve të përfituara, ai erdhi në përfundim se ajo substancë **nuk** është substancë e thjeshtë. Pranë çdo pohimi për substancën e zbuluar, rrethoni shkronjën **S**, nëse pohimi është i saktë, ose shkronjën **P**, nëse është i pasaktë.
- a) Ndodhet në grupin e dytë të Sistemit periodik të elementeve. S P
 - b) Me zbërthimin termik të sajë formohen substanca të reja. S P
 - c) Përbërja kimike e sajë paraqitet me formulë kimike. S P
 - d) Përbëhet nga atomet e të njëjtit element. S P


5. Analizo paraqitjet e modeleve të grimcave dhe në vija shkruaj përgjigjet e kërkuara.



- a) Nëse ☐ paraqet protonin, modeli i paraqitur saktë i grimcës neutrale është shënuar me numrin _____.
- b) Nëse ☐ paraqet protonin, modeli i paraqitur saktë i grimcës neutrale është shënuar me numrin _____.

6. Në fushat e zbrazëta të skemës së dhënë, radhitni nocionet e dhëna. Disa fusha mund të përmbajnë më shumë se një nocion.

Nocionet: uji, substancë e pastër, natrium, argjend, neon, element, azot, oksid-karboni(IV), gaz inert, jometal.



7. Në vijë shkruaj simbolin dhe emrin e elementit me numrin atomik më të vogël, izotopi më i përhapur i të cilit përmban të tri llojet e grimcave subatomike (protone, neutrone, elektrone).

Përgjigje: _____

8. Janë dhënë dy bashkësi: bashkësia A dhe bashkësia B.

$$A = \{ {}_{11}\text{Na}^+, {}_{17}\text{Cl}^-, {}_3\text{Li}^+, {}_8\text{O}^{2-} \}$$

$$B = \{ {}_2\text{He}, {}_{18}\text{Ar}, {}_{10}\text{Ne} \}$$

Çdo anëtar i bashkësisë A, caktoji anëtarin përkatës të bashkësisë B. Përgjigjet shkruaji në vendet e parashikuara në tabelë.

Bashkësia A	${}_{11}\text{Na}^+$	${}_{17}\text{Cl}^-$	${}_3\text{Li}^+$	${}_8\text{O}^{2-}$
Bashkësia B				

9. Një atom i elementit $_{20}\text{A}$ dhe një atom i elementit B gjithsejt kanë 29 elektrone. Rrethoni shkronjën para formulës kimike të komponimit të këtyre dy elementeve.

a) A_2B_5 b) AB_2 c) A_2B d) AB

10. Vjollca duhet të zhvillojë eksperimentin me tri sfera me masë të ngjashme. Të dhënat për materialet nga të cilat janë punuar sferat janë dhënë në tabelë.

Materiali	qelqi	argjendi	hekuri
Densiteti, g/cm^3 (g cm^{-3})	2,5	10,5	7,8

Rretho fjalën e **theksuar** ashtu që të fitosh pohim të saktë mbi rezultatin e eksperimentit të Elenës.

Nëse Vjollca i fut këto sfera në tri menzura identike, të mbushura deri në të njëjtën vijë me ujë të destiluar, rritjen më të madhe të nivelit të lëngut do ta shkaktojë sfera e punuar nga **qelqi/argjendi/hekuri**.

11. Akulli i thatë është emërtimi për oksidin e karbonit(IV), CO_2 , i cili në presion atmosferik standard dhe temperaturë prej $-79\text{ }^\circ\text{C}$ gjindet në gjendje agregate të ngurtë. Në presion të njejtë dhe në temperaturë të lartë, CO_2 kalon drejtpërdrejt nga gjendja agregate e ngurtë në të gaztë, duke krijuar efektin e tymit artificial, gjë që përdoret për efektet skenike apo në festa dhe evente të ndryshme.

Rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë.

I	Struktura kristallore e akullit të thatë është e ndërtuar nga: a) atomet b) molekulat c) jonet
II	Oksid-karboni(IV) në temperaturë dhome dhe presion atmosferik është: a) i ngurtë b) i lëngët c) i gaztë
III	Kalimi i drejtpërdrejt nga gjendja agregate e ngurtë në të gaztë quhet: a) kondenzim b) sublimim c) kristalizim

12. Në shishen e heqësit të llakut të thonjve (acetonit) ndodhen shenjat e mëposhtme të paralajmërimit (piktogramet). Rrethoni shkronjat para pohimeve që përshkruajnë rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të këtij produkti.



- a) Produkti mund të eksplodojë (shpërthej) si pasojë e tundjes.
b) Produkti mund të shkaktojë iritimin e lëkurës apo syrit.
c) Produkti është lehtë i ndezshëm.
d) Produkti nuk digjet, por mundëson ndezjen e substancave tjera.

13. Në secilin varg rrethoni “të paftuarin”.

a) S_8 , Na, P_4 , N_2 , O_2 c) C, K, H_2O , Al, Fe
b) H_2 , N_2 , NaCl, O_2 , Cl_2 d) NaCl, H_2S , KF, CaO, MgCl_2

14. A dhe B janë elemente të periodës së dytë të Sistemit periodik të elementeve (SPE). Elementi A ndodhet në grupin 15, ndërsa elementi B në grupin 16 të SPE.

Në vija shkruaj radhitjen e elektroneve nëpër nivele energjetike:

- I
a) në atomin e elementit A _____
b) në atomin e elementit B _____

Elementi A dhe elementi B ndërtojnë disa komponime. Në këto komponime valenca e elementit A ndryshon, ndërsa valenca e elementit B është e përhershme.

- II
Rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë. Elementet A dhe B ndërtojnë komponime me:
a) lidhje jonike b) lidhje kovalente


Valenca e elementit B i përgjigjet numrit të elektroneve që i mungojnë atomit të atij elementi për të pasur radhitjen e elektroneve si atomi i gazit inert më të afërt. Valenca maksimale e mundshme e elementit A i përgjigjet numrit të elektroneve valentore në atomin e atij elementi.

III
Në vijë shkruaj formulën e komponimit të ndërtuar nga elementet A dhe B, në të cilin elementi A është me valencën më të madhe të mundshme. _____


15. Rrethoni shkronjat para pohimeve **të pasakta**.

- a) Masa e atomit është e përqëndruar në bërthamë.
b) Numri i protoneve në atom është gjithmonë i barabartë me numrin e neutroneve.
c) Masat e protoneve dhe neutroneve në atom janë përafërsisht të barabarta.
d) Largësia e elektroneve nga bërthama e atomit është e barabartë në të gjitha nivelet energjetike.


16. Në vizatime janë paraqitur me rrathë të zinj dhe të bardhë atomet e elementeve të ndryshëm, të cilët mund të jenë të lidhur mes veti. Rrethoni shkronjën poshtë vizatimit të përzierjes së elementeve.




a)



b)



c)



d)

17. Shkumësi shkollor në kushte standarde është në gjendje agregate të ngurtë. Me rastin e shkruarjes, shkumësi len gjurmë të bardhë në tabelë. Shkumësi mund të thyhet lehtë në pjesë më të vogla përmes shtypjes. Kur një copë shkumësi laget me acid acetik, vije deri te shushuritja dhe shkumimi.


Vijëzo **të pasaktën** (të pasaktën) në pohimet vijuese.

- a) Gjendja agregate është veti **fizike/kimike** e shkumësit.
b) Shushuritja e përshkruar dhe shkumimi është tregues i ndryshimit **fizik/kimik** të shkumësit.
c) Fortësia është veti **fizike/kimike** e shkumësit.
d) Thyerja e shkumësit është ndryshim **fizik/kimik** i shkumësit.
e) Ngjyra e bardhë e shkumësit është veti **fizike/kimike**.

18. Bromi ka dy izotope stabile X dhe Y, të cilët përbëjnë gati gjithë bromin e njohur në natyrë. Numri i masës së izotopit X është i barabartë me numrin atomik të arit dhe është 79. Atomi i izotopit Y në bërthamë ka 35 protone, ndërsa numri i neutroneve në bërthamë të atomit të izotopit X është për dy më i vogël se numri i neutroneve në bërthamën e atomit të izotopit Y. Plotëso tabelën me të dhënat për izotopet X dhe Y.

Izotopi	X	Y
Simboli i elementit		
Z		
A		

19. Vëllimi i ujit prej 600 cm^3 (ml) është shpërndarë në gotë, erlenmajer dhe menzurë siç është paraqitur në foto.



Plotëso fjalitë vijuese.

- a) Vëllimi më i vogël i lëngut që mund të matet me menzurën e dhënë është _____ cm^3 .
- b) Vëllimi më i madhë i lëngut që mund të matet me gotën e dhënë është _____ cm^3 .
- c) Vëllimi më i vogël i lëngut i cili mund të matet me erlenmajerin e dhënë është _____ cm^3 .

20. Radhitja e elektroneve nëpër nivele në atomin e elementit të shënuar me E është K-2 L-8.

I Në vija shkruaj:

- a) radhitjen e elektroneve në mbështjellësin elektronik të elementit A i cili ndodhet para elementit E në SPE _____
- b) radhitjen e elektroneve në mbështjellësin elektronik të atomit B i cili vjen pas elementit E në SPE _____
- c) formulën e komponimit të cilin e ndërtojnë elementet A dhe B _____

II Në pohimet vijuese rrethoni fjalën e **theksuar** të saktë.

- a) Elementi E është **metal/jometal/gaz inert**.
- b) Elementi A është **metal/jometal/gaz inert**.
- c) Elementi B është **metal/jometal/gaz inert**.
- d) Elementet A dhe B ndërtojnë komponimin me lidhje **kovalente polare/jonike/kovalente jopolare**.
- e) Komponimi i elementeve A dhe B në kushte standarde është në gjendje agregate të **ngurtë/lëngët/gaztë**.